Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01 -138
Datë 19.08.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 03.08.2016 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e institucionit "A.S. Consulting S.r.l." - Dega në Kosovë, për periudhën 3 vjeçare, prej 03. 08. 2016 deri 03. 08. 2019 për këtë kualifikim të aprovuar:

1.1. Furrtar, niveli i KKK-së (III).

Validimi i kualifikimeve dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të sigurohet kuadër profesional i Teknologjisë Ushqimore (së paku një ekspert) me marrëveshje të nënshkruar bashkëpunimi së paku 3 vjeçar, me nivel kualifikimi minimal Bachelor.
- Të krijohet një format vlerësimi nga ana e menaxhmentit dhe Koordinatorit të cilësisë për vlerësimin dhe mentorimin/ këshillimin e instruktorëve.
- Të krijohen mundësi për lidhje bashkëpunimi me bizneset e ndryshme furrtare (Kontrata të nënshkruara bashkëpunimi).

- Të sigurohen pajisje (enë metalike) të ndryshme për dhënien e formave për pjekurina nga brumërat.
- Të rregullohet dhe inventarizohet (pajiset) me dollapë dhoma e gardërobës.

(Afati kohor: 10. 10. 2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 26.07.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacionin për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucion Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë.

Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
   - Institucionit "A.S. Consulting S.r.l."- Dega në Kosovë; dhe
   - AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Osman Buleshkaj